



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Nr. 1631 Prot.

Date 02/ 02/ 2021

**P/VENDIM**

Nr.    / Datë 02.02.2021

**PËR**

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË RISHIKIMIT TË PLANIT TË DETYRUAR  
VENDOR PDyV, ZRZH “1 Lezhë”, BASHKIA LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 112 “Përgjegjësitë e këshillit bashkiak”, në ligjin 107/2014 date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në ligjin 139/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, në ligjin nr.97/2019 “Për miratimin e aktit normative nr.9 dt 16/12/2019, të Këshillit të Ministrave, “Për perballimin e pasojave të fatkeqesise natyrore”, vendimit nr.887, dt.24.12.2019 të Këshillit të Ministrave” për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të vendimit nr.134, datë 13.02.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në, Lezha 1, Njësinë Administrative Lezhë, Bashkia Lezhë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, në zbatim të Vendimit Nr.64, date 07.12.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindertimit, Këshilli i Bashkisë,

**V E N D O S I:**

- 1- Miratimin e rishikimit të Planit të Detyruar Vendor PDyV ZRZH “1 Lezhë”, Njësia Administrative Lezhë, Bashkia Lezhë.
- 2- Pjesë integrale e këtij vendimi janë Dokumentat e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor, Lezha 1, Bashkia Lezhë
  - Dokumenti i Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor, PDyV ZRZH “1 Lezhë”.
  - Materiali hartografik.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban në Bashkinë Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

Pjerin  
Ndreu

Digitally signed by  
Pjerin Ndreu  
Date: 2021.02.02  
07:18:46 +02'00'